

## KONTRATE SHITJE KUOTASH



Sot, me Tirane, me daten 10.09.2003 ( dhjete shtator te vitit dymijje e tre), bazuar ne nenin 705 e vijues te Kodit Civi si dhe ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 „Per Shoqerite Tregtare“, lidhet kjo kontrate per shitjen e kuotave mes paleve :

**SHITESI :** Gianfranco Liuzzi, i biri i Oronzo, lindur me 6/04/1947 me Locorotondo, Bari, Itali, shtetas italian, mbajtes i pashaportes me numer 652377 N, dhe banues ne Bari, Via „Conte Giusso“ 13/e, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut te Vetem te Shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k, qe zoteron 100 % (njqindperqind) te kapitalit te kesaj shoqerie, me seli ne Tirane Rruga „ Tefta Tashko“104/6, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 16305, date 16/11/1996 te Gjykates se Rrethit Tirane.

**BLERESI :** Shoqeria Anonime pa Oferte Publike „ 5 SHQIPTARE“ SH.A., regjistruar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane me Vendimin nr. 29099, date 17.02.2003, perfaqesuar nga Drejtori i Shoqerise Z.Naim Jashari, i biri i Tofikut, I datelindjes 6.03.1958 lindur dhe banues ne Shijak, Durres, shtetas shqiptar, mbajtes i pasaportes me numer 2032.9103, madhor me zotesi te plote per te vepruar .

Shitesi, Gianfranco Liuzzi, ortaku i vetem shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k, qe ka fituar personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin nr. 16305, date 14/11/1996, shet dhe Bleresi, Shoqeria Anonime pa Oferte Publike „ 5 SHQIPTARE“ SH.A, blen 100 % ( njqind perqind ) te kuotave te kapitalit te shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k

Shitesi, Gianfranco Liuzzi, bazuar ne vendimin nr \_\_, date 10.09.2003 te Ortakut te vetem te shoqerise „TEKNOMEDIA“ sh.p.k ka vendosur shitjen e 100 % te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie Shoqerise Anonime pa Oferte Publike “5 SHQIPTARE” SH.A.

Bleresi, Shoqeria Anonime pa Oferte Publike „ 5 SHQIPTARE“ SH.A, bazuar ne Vendimin nr. 1, date 10.09.2003 te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise, eshte dakort te bleje 100 % te kuotave te shoqerise “TEKNOMEDIA” sh.p.k sipas kushteve qe do te percaktohen nga bleresi.

Shitesi dhe Bleresi me vullnetin e tyre te lire kane rene dakort si me poshte :





## NENI 1

### Objekti i Kontrates

Shitesi i shet Bleresit 100 % (njqind perqind ) te kuotave te kapitalit te shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k, qe aktualisht zoterohen nga Shitesi Gianfranco Liuzzi, i cili eshte dhe ortak i vetem i shoqerise „ Teknomedia“ sh.p.k

Shitesi Gianfranco Liuzzi, pas nenshkrimit te kesaj kontrate largohet nga shoqeria „Teknomedia“ sh.p.k duke hequr dore dhe si administrator I shoqerise.

## NENI 2

### Formimi i Kapitalit te Shoqerise

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, bleresi Shoqeria Anonime pa Oferte Publike „ 5 SHQIPTARE“ SH.A behet ortak i vetem i shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k kapitali i te ciles tashme eshte i formuar si me poshte :


- **Shoqeria Anonime pa Oferte Publike „5 SHQIPTARE“ SH.A** zoteron 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise „Teknomedia“ sh.p.k.

## NENI 3

### Cmimi dhe Kushtet e Pageses

Vlera e cdo kuote te shoqerise do te jete nje kuote baraz me 1.000 Euro. Ky do te jete cmimi i shitjes se kuotave, te cilat do te blihen nga shoqeria „5 SHQIPTARE“ SH.A.

Bleresi deri ne momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate i ka paguar Shitesit vleren prej 100.000 ( njqind mije) Euro qe eshte kapitali themeltar i shoqerise „ Teknomedia“ sh.p.k.





**NENI 4**

*Te Drejtat dhe Detyrimet e Shitesit*

Shitesi deklaron se me shitjen e ketyre kuotave i kalon Bleresit edhe te gjitha te drejtat qe gezon kjo shoqeri.

Shitesi deklaron se te gjitha detyrimet qe ka shoqeria „ Teknomedia“ sh.p.k. ndaj shtetit shqiptar dhe ndaj cdo personi fizik apo juridik ( te treteve) deri ne momentin e nenshkrimt te kesaj kontrate, pamvaresisht nga koha kur njoftohen ato, jane ne ngarkim te shitesit Gianfranco Liuzzi.

**NENI 5**

*Te Drejtat dhe Detyrimet e Bleresit*


Bleresi eshte dakort qe te permbushe kushtet e vena nga shitesi ne kete kontrate si dhe te perballoje te gjitha shpenzimet per pasqyrimin e ketyre ndryshimeve ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane.

**NENI 6**

*Korespondenca*

Korespondenca mes paleve nenshkruese te kesaj Kontrate do te behet ne adresat zyrtare si me poshte :

- 3. Per Shitesin Rruga „ Tefta Tashko“ nr. 1006, Tirane
- 4. Per Bleresin Prane Rruga „ J. Popovic“ nr. 1006, ap. —, Tirane



**NENI 7**

*Ligji i aplikueshem dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve*

Kontrata eshte e bazuar ne legjislacionin shqiptar.

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin ne interpretimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate si dhe ne pergjithesi te gjitha mosmarveshjet midis Shitesit dhe Bleresit



ne qartese nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve do te zgjidhen ne Gjykatën e  
Rrethit/Tirane.

**NENI 8**

Gjuha e kontrates

Kjo Kontrate eshte hartuar ne kater kopje origjinale.

Kontrata pasi u lexua u firmos rregullisht nga palet.

**SHITESI**

**Gianfranco LIUZZI**

GIANFRANCO LIUZZI  
*Gianfranco Liuzzi*

**BLERESI**

**Shoqeria „5 SHQIPTARE“ SH.A.**

**Naim JASHARI**

**DREJTOR I SHOQERISE**

*Naim Jashari*

